



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:158314  
Datë: 11.10.2024  
Numri i dokumentit: 06285696

C.nr.1263/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Blerina KURTAJ, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses: 1. P.H., 2. S.H., 3. E.H., që të tre nga K- Gjakovë, të cilët sipas autorizimit e përfaqëson Av. Faruk Binakaj me seli në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Illyria", Zyra qendrore në Prishtinë, me objekt kontesti: Zhdëmtim sipas autopërgjegjesise, vlera e kontestit 1000.00 euro, më 11 Tetor 2024, jashtë seancës, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia me numër C.nr.1263/24 e datës 02.05.2024 e paditësve : 1. P.H., 2. S.H., 3. E.H., që të tre nga K- Gjakovë, kundër të paditurës kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Illyria", Zyra qendrore në Prishtinë, me objekt kontesti: Zhdëmtim sipas autor përgjegjesisë.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit 1. P.H., 2. S.H., 3. E.H., që të tre nga K- Gjakovë, kanë paraqitur padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Illyria", Zyra qendrore në Prishtinë, me objekt kontesti: Zhdëmtim sipas autopërgjegjjesise.

Gjykata me anë të Aktvendimit C.nr.1263/24 të datës 02.09.2024, të cilin i autorizuari e paditësve e ka pranuar me datë 13.09.2024, e ka obliguar paditësin që të paguajë taksën gjyqësore në shumën prej 20.00.-€, e paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr.01/2017, për unifikimin e

taksave gjyqësore, dhe atë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vërejtjes gjyqësore. I autorizuari e paditësve nuk ka vepruar sipas aktvendimit dhe nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Andaj, sipas nenit 253 paragrafi 5 të LPK-së *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, konform nenit 253 paragrafi 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË  
-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil-  
C.nr.1263/24, me 11 Tetor 2024

Gj y q t a r j a  
Blerina KURTAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.